



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Regulativni Autoritet Železnica

Railway Regulatory Authority



DEP/SEK:	APR	782
DEP/SEK:		
DEP/SEK:		
NUMRI FAQE:		
BROJ STRANE:	6	
NR OF PAGE:		
DATA:	01/11/2013	

Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

Rregullore Nr. 03/2013 Metoda e përgjithshme e sigurisë për mbikëqyrje nga Organi përgjegjës i sigurisë pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i Rregullores është që përmes rregullave të përcaktuara në këtë rregullore, ARH-ja të paraqesë procedurat dhe kriteret që duhet të përmbushën në procesin e mbikëqyrjes së sigurisë pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë, në mënyrë që procesi të jetë i qartë dhe transparent.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore krijon një metodë të përgjithshme të sigurisë (MPS) për mbikëqyrjen e ecurisë së sigurisë pas lëshimit të një certifikate të sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore ose një autorizimi të sigurisë për menaxherët e infrastrukturës.

ARH si organ përgjegjës i sigurisë duhet të aplikojë metodën e përgjithshme të sigurisë për të vëzhguar përputhjen me obligimin ligjor në një ndërmarrje hekurudhore (NH) ose menaxher të infrastrukturës (MI) për të përdorur një sistem të menaxhimit të sigurisë për të siguruar kontrollimin e të gjitha rreziqeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e tyre duke përfshirë pajisjet për mirëmbajtje, furnizimin me material dhe përdorimi i kontraktorëve, kur është e përshtatshme edhe për të kontrolluar aplikimin e rregullores për monitorim që duhet të aplikohet nga ndërmarrjet hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës pas pranimit të një certifikate të sigurisë ose autorizimi të sigurisë dhe entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtje.

Organi përgjegjës i sigurisë duhet të përdorë këtë rregullore për t'i kryer aktivitetet e tij të mbikëqyrjes sipas Nenit 18 paragrafi 3.4, nenit 116 paragrafët 4.1 dhe 4.2 të ligjit për hekurudhat e Kosovës dhe Rregullores Nr. 1077/2012/EU të komisionit Evropian.

Neni 3 Përkufizimi

Për qëllime të kësaj rregulloreje, përkufizimi në vijim do të aplikohet: "Mbikëqyrja" nënkuption masat e vënë në fuqi nga ana e Organit të sigurisë për të mbikëqyrur performancën e sigurisë, pas dhënies së certifikatës apo autorizimit të sigurisë.

Neni 4 Strategjia e mbikëqyrjes dhe plani (et)

1. Organi nacional i sigurisë duhet të krijoj dhe implementoj një strategji dhe plan të mbikëqyrjes që përshkruan se si synon ti zhvillojë aktivitetet dhe i cakton prioritetet për mbikëqyrje siç përcaktohet në Aneks.
2. Organi nacional i sigurisë duhet të mbledhë dhe të analizoj informata nga burime të ndryshme. Duhet të përdorë informacionin e mbledhur dhe rezultatet e mbikëqyrjes për qëllime të caktuara në Nenin 1.
3. Organi nacional i sigurisë duhet që rregullisht të kontrolloj (rishikoj) strategjinë dhe planin apo planet duke pasur parasysh përvojën, duke përdorur informacionin e mbledhur dhe rezultatet e mbikëqyrjes.

Neni 5 **Teknikat për kryerjen e mbikëqyrjes**

1. Organi nacional i sigurisë duhet të miratoj teknika për aktivitetet e mbikëqyrjes. Këto teknika zakonisht përfshijnë intervistat me njerëz në nivele të ndryshme në një organizatë, kontrollimin e dokumenteve dhe regjistrimeve që kanë të bëjnë me sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe ekzaminimin e rezultateve të sigurisë së sistemit të menaxhimit të shpallura nga inspektorët ose aktivitetet e ngjashme.
2. Organi nacional i sigurisë duhet të siguroj që aktivitetet e sajë të mbikëqyrjes përfshijnë kontrollimin e:
 - (a) efikasitetit të sistemit të menaxhimit të sigurisë;
 - (b) efikasitetin e elementeve individuale ose të pjesshme të sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë aktivitetet operative.

Neni 6 **Lidhjet ndërmjet vlerësimit dhe mbikëqyrjes**

1. Organi nacional i sigurisë duhet të shfrytëzoj informacionin e mbledhur gjatë vlerësimit të një sistemi të menaxhimit të sigurisë të një ndërmarrjeje hekurudhore ose të një menaxheri të infrastrukturës për qëllime të mbikëqyrjes së tyre të aplikimit të vazhdueshëm të sistemit të tyre për menaxhimin e sigurisë pas lëshimit të certifikatës së sigurisë ose autorizimit të sigurisë.
2. Organi nacional i sigurisë duhet gjithashtu të shfrytëzoj informacionin e mbledhur gjatë aktiviteteve të tij të mbikëqyrjes për rivlerësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë të një ndërmarrjeje hekurudhore ose një menaxheri të infrastrukturës para ripërtrirjës se një certifikate ose autorizimi të sigurisë.

Neni 7 **Kompetenca e personave të përfshirë në aktivitetet e mirëmbajtjes**

Organi nacional i sigurisë duhet të ketë një sistem të caktuar për të siguruar që aktivitetet e mbikëqyrjes janë ndërmarrë nga personat kompetent.

Neni 7 **Kriteri i vendim-marrjes**

1. Organi nacional i sigurisë duhet të formuloj dhe të publikoj kriterin e vendimmarrjes se si i monitoron, promovon dhe kur është e duhur i zbaton përputhshmërinë me kornizën e rregullatorit të sigurisë. Këto kritere duhet që gjithashtu të përfshijnë çështjet e mos-përputhjes që kanë të bëjnë me aplikimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë nga një ndërmarrje hekurudhore ose menaxheri të infrastrukturës dhe të fushës së veprimit të rregullatorit të sigurisë.

- Organ i nacional i sigurisë duhet të miratoj dhe të publikoj një procedurë për tu mundësuar ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherëve të infrastrukturës që të paraqesin ndonjë ankesë në vendimet e marra gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes, pa rënë ndesh me kërkesat për një rigjykim gjyqësor të atyre vendimeve.

Neni 8 **Koordinimi dhe kooperimi**

- Organ i nacional i sigurisë i përfshirë në mbikëqyrjen e një ndërmarrjeje hekurudhore e cila operon në më shumë se një shtet duhet të koordinoj qasjen e tyre me mbikëqyrjen për të siguruar që sistemi i menaxhimit të sigurisë së ndërmarrjes hekurudhore është efektiv dhe përfshinë të gjitha aktivitetet relevante. Aktivitetet e koordinimit duhet të përfshijnë marrëveshjen për atë se çfarë informacioni mund të shpërndahet ndërmjet autoriteteve nacionale të sigurisë në mënyrë që të siguroj një qasje të përgjithshme në mbikëqyrjen e ndërmarrjes hekurudhore përkatëse. Duhet gjithashtu të përfshijë strategjinë për shpërndarjen e informacionit dhe planin e mbikëqyrjes apo planet e autoriteteve nacionale të sigurisë, duke përfshirë çfarëdo rezultati përkatës për të mundësuar një qasje të përbashkët për t'u marrë me mos-pajtueshmëritë.
- Organ i nacional i sigurisë duhet të krijojë marrëveshje bashkëpunimi me organet nacionale të hetuesisë, organet për certifikimin e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtje dhe autoriteteve tjera kompetente në mënyrë që të shpërndajnë informacionin dhe që të koordinojnë përgjigjet e tyre ndaj çfarëdo dështimi për përbushur fushën e veprimit të rregullatorit që ka të bëjë me çështje të sigurisë

Neni 9 **Hyrja në fuqi dhe aplikimi**

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të sajë.

Halit Gara,
Kryesues i Bordit Mbikëqyrës
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Prishtinë, 29.10.2013



ANEKS

1. Fillimi i strategjisë dhe planit (ëve) të mbikëqyrjes

Organ i nacional i sigurisë duhet:

- (a) Të identifikoj zonat në shënjestër të aktiviteteve të mbikëqyrjes;
- (b) Të krijoj një plan ose plane mbikëqyrëse të cilët tregojnë se si do të funksionoj strategja e mbikëqyrjes gjatë periudhës së funksionimit të një certifikate të sigurisë/autorizimi të sigurisë;
- (c) Të prodhoj një vlerësimi fillestar të burimeve të kërkua të dhëni e efektit për planin apo planet, bazuar në zonat e synuara të identikuara;
- (d) Të alokoj burimet për të dhënë efektin për planin apo planet;
- (e) Përdorimi i të dhënavë/informacionit nga një burime të ndryshme si të dhëna për strategjinë dhe planin ose planet. Burimet mund të përfshijnë informacion të mbledhur gjatë vlerësimit të sistemeve të menaxhimit të sigurisë, rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të mbikëqyrjes, informacioni nga autorizimet për t'i vënë nënsistemet ose mjetet lëvizëse në shërbim, organet nationale të hetuesisë së raporteve të aksidenteve/rekomandimeve, raportet e tjera të aksidenteve/incidenteve, raportet vjetore të mirëmbajtjes nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtje, ankesat nga anëtarët e publikut dhe burimet e tjera përkatëse.

2. Lidhja e strategjisë dhe planit(ëve) të mbikëqyrjes

Organ i nacional i sigurisë duhet:

- (a) T'u komunikoj objektivat e përgjithshme të strategjisë së mbikëqyrjes dhe sqarimit të përgjithshëm të planit ose planeve për ndërmarrjet e caktuara hekurudhore ose menaxherët e infrastrukturës dhe kur është e duhur, më gjerësisht tek grupet e tjera të interesit;
- (b) Pajisin ndërmarrje të caktuara hekurudhore ose menaxherë të infrastrukturës me një sqarim të përgjithshëm në atë se si do të ndërmerr plani apo planet e mbikëqyrjes.

3. Përfundimi i strategjisë dhe planit(ëve) të mbikëqyrjes

Organ i nacional i sigurisë duhet:

- (a) Zbatoj planin ose planet siç është paraparë;
- (b) Të marrë veprime të duhura që të merret me dështim të zbatimit, duke përfshirë lëshimin e ndonjë alarmi urgjent të sigurisë kur është e nevojshme;
- (c) Të vlerësoj se sa në mënyrë të duhur e ka zhvilluar dhe implementuar një plan ose plane veprimi për të përmirësuar çfarëdo mospërputhje të identifikuar nga organi nacional i sigurisë brenda një periudhe të specifikuar kohore.

4. Rezultatet e planit(ëve) të mbikëqyrjes

Organi nacional i sigurisë duhet :

- (a) Ndajë rezultatet me ndërmarrje e caktuara hekurudhore ose menaxherin e infrastrukturës përfshirë zonat e identikuara të mospërputhshmërisë në pjesën e menaxherit të infrastrukturës ose ndërmarrjes hekurudhore;
- (b) Të ketë një pasqyrë të performancës së sigurisë së ndërmarrjeve individuale hekurudhore ose menaxherëve të infrastrukturës të cilët operojnë në shtetin e tyre;
- (c) Të publikoj dhe t'u komunikoj grupeve përkatëse të interesit qëllimet e tij rrëth performancës së përgjithshme të sigurisë në shtetin tije;
- (d) Të publikoj dhe t'u komunikoj grupeve përkatëse të interesit qëllimet e tij rrëth efikasitetit të fushës së veprimit të rregullatorit të sigurisë.

5. Rishikimi i veprimeve të mbikëqyrjes

Në bazë të eksperiencës së fituar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes, organi nacional i sigurisë duhet që rregullisht:

- (a) Të sjell një rishikim të planit ose planeve për të kontrolluar fillimin e aktivitetit të planifikuar, përdorimin e të dhënavë/informatave nga burime të ndryshme, rezultatet e mbikëqyrjes dhe alokimi i resurseve janë të përshtatshme, ndryshimi i prioriteteve kur është e nevojshme;
- (b) Të bëjë ndryshime të nevojshme në planin apo planet nëse ato janë për t'u përmirësuar dhe të marrë parasysh ndikimin e ndryshimeve në strategjinë e mbikëqyrjes;
- (c) Të kontribuoj kur është e nevojshme me pikëpamjet dhe propozimet e tij për të kapërcyer çfarëdo mangësie në fushën e veprimit të rregullatorit të sigurisë.